



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.2208/18 prot.

Datë 04.04.2023

**V E N D I M**  
**Nr. 248/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.04.2023 me

- Objekt:** “Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “STUDIOS-SERVICES K – SA” SHPK në procedurën e prokurimit “*Shërbim konsulence*” me Nr. REF-27372-05-04-2022 me objekt “*Hartim projekti rehabilitimi rruges "A.Goga - Spitali"* me fond limit 4.166.660.0 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 2022-06-20 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durres.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK  
Adresa: *Rruga Egnatia dhe Rruga ramazan Jella, pallati 1125, Kati i parë*
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Durrës  
Adresa: *Sheshi “Liria”, Qyteti Durrës*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020

datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

## **Vëren:**

### **I**

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 10.05.2022 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Shërbim konsulence” me Nr. REF-27372-05-04-2022 me objekt “Hartim projekti reabilitimi rruges “A.Goga - Spitali” me fond limit 4.166.660.0 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 2022-06-20 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durres.

II.2. Në datën 10.10.2022 operatori ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 2208 prot,. Datë 10.10.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2603. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Studio Services K-SA” SHPK.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në

bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2208/2 prot., datë 11.10.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimes “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK, për të cilat ngrihen pretendime.

II.4. Me shkresën nr. 2976/29 prot., datë 01.11.2022, protokolluar me tonën me nr. 2208/4, datë 03.11.2022 me objekt “Vendim i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës sipas Urdhërit nr. 503, datë 13.10.2022, i ndryshuar me Urdhërin nr. 518, datë 20.10.2022 mbi ankesën e ardhur nga Operatori Ekonomik “Studio Services” K-SA” Shpk për procedurën me objekt: Hartim projekti rehabilitimi rrugës Ä. Goga-Spitali.” autoriteti kontraktor ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik në lidhje me përgjigjen për OE ekonomik ankimes si vijon: *“Refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik STUDIO SERVICES “K – SA” shpk, pasi pretendimet e ngritura në ankesë, nuk qëndrojnë. Pretendimi i referuar mos publikimit të VKM-së 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudimi” në DST, dhe se oferta e tij duhet të vlerësohet pasi ishte ofertë e favorshme. Nga verifikimet e kryera propozimi ekonomik i sjellë nga OE rezulton poshtë vlerës minimale të hartuar nga grupi i specifikimeve teknike/termat e referencës, për rrjedhojë vlera e përlllogaritur e prokurimit, sipas nenit 34 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, duhet të jetë vlerë reale e cila të përfshijë të gjitha shërbimet e kërkuara në DST dhe në formë të padiskutuar duhet të jetë në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi. Mos respektimi i akteve dhe nën akteve ligjore sjell shkelje të rregullave të prokurimit publik.*

*Në detyrën e projektimit për hartimin e projektit, materiali i hartuar nga grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike (termat e referencës) si dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit me objekt: “Hartim projekt rehabilitimi rrugës “A. Goga-Spitali”, sipas urdhërit nr. 148, datë 05.04.2022, në kërkesat që duhet të zgjidhë projekti, pika 02.3 citohet: “SHËRBIMET E KËRKUARA Sërbimet e kërkuara do të jenë në përputhje me përcaktimet e VKM 354, datë 11.05.2016. Hartimi i projektit duhet të realizohet në përputhje me kërkesat e detyrës së projektimit.” Për rrjedhojë OE është plotësisht i mirëinformuar se si duhet të hartojë dokumentacionin në fjalë në zbatim absolut të legjislacionit në fuqi pqrforcuar gjithashtu dhe në shkresën me Nr. 5585 prot., datë 25.07.2017 nga Agjencia e Prokurimit Publik*

*Sa më sipër pretendimi i mos informimit mbi VKM-në 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”, nuk qëndron për aq sa është përmendur në termat e referencës/ specifikimet teknike dhe detyrat e projektimit. Gjithashtu citimi ose jo i një vendimi të këshillit të ministrave nuk duhet të pengojë zbatimin e legjislacionit në fuqi.”.*

II.5. Për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, si dhe marrë shkas nga kërkesa e ankimesit për ekspertizë të posaçme, Komisioni i Prokurimit Publik për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimes, vendos të thërrasë ekspertin e fushës për përlllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

- II.6. Me antë të shkresës me nr.2208/6 prot., datë 15.11.2022 Komisioni vë në dijeni palët për shtyrje e afatit me dalje në vendim për shkaqe të nevojshme për verifikim.
- II.7. Më anë të shkresës 2208/7 prot., datë 21.11.2022 Komisioni i Prokurimit Publik i kërkon informacion autoritetit kontraktor në lidhje me përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.
- II.8. Me anë të shkresës me nr. 2208/9 prot., datë 30.11.2022, Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesë për ekspertizë në lidhje me përlllogaritjen e vlerës minimale dhe maksimale të fondit limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.
- II.9. Me anë të shkresës me nr. 2208/10 prot., datë 14.12.2022, Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon edhe një herë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë kërkesën për ekspertizë.
- II.10. Me anë të shkresës nr. 712 prot., datë 19.01.2023 me objekt “Kthim përgjigje” protokolluar me tonën me nr. 2208/11 datë 20.01.2023, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës bën me dije se nuk mund të shprehet për dhënien e ekspertizës pasi nuk ka ekspertë.
- II.11. Me anë të shkresës me nr. 2208/12 prot., datë 27.01.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon Universitetit Politeknik të Tiranës kërkesë për ekspertizë në lidhje me përlllogaritjen e vlerës minimale dhe maksimale të fondit limit për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.
- II.12. Me anë të shkresës me nr. 2208/14 prot., datë 08.02.2023, Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon edhe një herë Universitetit Politeknik të Tiranës kërkesën për ekspertizë.
- II.13. Me anë të shkresës nr. 256/1 prot., datë 13.02.2023 me objekt “Kthim përgjigje shkresës nr.2208/12., datë 27.01.2023” protokolluar me tonën me nr. 2208/15 datë 15.02.2023, Universiteti Politeknik i Tiranës bën me dije se ky shërbim ka një specifikë të ndryshme nga ato që ofrojmë dhe nuk përfshihet në fushat e ekspertizës të Universitetit Politeknik të Tiranës.
- II.14. Ndodhur në këto kushte në pamundësi të gjetjes së ekspertit, Komisioni i Prokurimit Publik në datën 21.02.2023 në faqjen e saj shpall konkurrimin për, Inxhinier/ekspert në përlllogaritjen kostove për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.
- II.15. Në datën 09.03.2023 Komisioni i Prokurimit Publik mori Vendimin nr. 188/2023 datë 09.03.2023 me objekt: Për një shtesë në listën e ekspertëve të miratuar për vitin 2023, me Vendim Nr. 1237/2022, datë 12.12.2022.

II.16. Eksperti zgjidhet nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar në përputhje me nenin 24 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik,

II.17. Ndërmjet ekspertëve, të cilët referuar dokumentacionit zotërojnë kualifikimet e kërkuara për kryerjen e ekspertizës, u zgjodh Eksperti Bujar Bundo, i cili do të asistojë Komisionin e Prokurimit Publik në zgjidhjen e çështjes objekt-ankimi.

II.18. Në datën 09.03.2023 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u paraqit eksperti Z. Bujar Bundo me profesion inxhinier/ekspert në përlllogaritjen e kostove për shërbimet në planifikim territory, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim, ekspert i pavarur, nga lista e ekspertëve të KPP-së, me të cilin u mbajt procesverbali përkatës. Eksperti pranon, se është i specializuar për përlllogaritjen e fondit limit për përlllogaritjen e vlerës minimale dhe maksimale dhe përcaktoi tarifën prej 50,000 lekë për kryerjen e ekspertizës. Gjithashtu Eksperti pranon se për kryerjen e ekspertizës i nevojiten 10 ditë kohë nga marrja e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e përlllogaritjes së fondit limit.

II.19. Në datën 09.03.2023 me vendimin nr. 189/2023 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të urdhërojë kryerjen e Ekspertimit të Posaçëm lidhur me përlllogaritjen e vlerës minimale dhe maksimale të fondit limit për procedurën e prokurimit, nga eksperti i përzgjedhur nga lista e ekspertëve vjetorë të miratuar për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence” me Nr. REF-27372-05-04-2022 me objekt “Hartim projekti reabilitimi rruges “A.Goga - Spitali” me fond limit 4.166.660.0 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 2022-06-20 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durres.*
- 2. Operatori ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK të parapaguajë për llogari të z. Bujar Bundo shumën prej 50,000 lekë si tarifë e përcaktuar për kryerjen e ekspertimit dhe të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda datës 15.03.2023 ora 10:00.*
- 3. Autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim mbi çështjet që duhet të trajtohen nga Eksperti brenda datës 15 .03.2023.*
- 4. Në datën 15.03.2023 ora 10:00 të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik eksperti z. Bujar Bundo për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e ekspertizës, si dhe përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik.*

5. Pas paraqitjes së pretendimeve me shkrim nga palët eksperti ngarkohet të kryejë aktin e ekspertimit dhe të dorëzojë materialin në formë shkresore. Akti i ekspertimit të dorëzohet jo më vonë se data 31.03.2023.

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*

II.20. Në datën 15.03.2023 në ambientet e KPP, nuk u paraqit asnjë përfaqësues i autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK. Gjithashtu, Komisioni vëren, se operatori ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK nuk ka parapaguar për llogari të z. Bujar Bundo shumën prej 50,000 lekë si tarifë e përcaktuar për krerjen e ekspertimit dhe nuk ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda afatit të përcaktuar në vendimin e sipërcituar.

II.21. Me anë të shkresës së datës 16.03.2023, me objekt: “*Kthim përgjigje Vendimit tuaj me Nr. 186/2023 datë 09.03.2023 dhe Kthim Përgjigje shkresës tuaj me Nr. 2208/12 datë 27.01.2023*”, protokolluar me tonën me nr. 2208/17 prot., datë 16.03.2023, operatori ekonomik “STUDIO SERVICES K0SA” SHPK, kundërshton vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik nr. 189/2023, datë 09.03.2023, për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence” me Nr. REF-27372-05-04-2022 me objekt “Hartim projekti reabilitimi rrugës “A. Goga – Spitali” me fond limit 4.166.660 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë) lekë, pa TVSH, zhvilluar në datën 2022-06-20 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durrës, ku ndër të tjera në mënyrë të përmbledhur citohet se:

*“...Në konkluzion:*

*Në formularin e ankimit, ankuesi nuk ka kërkuar ekspertizë për respektim të **Vendimi 354 datë 11.05.2016**, por të hartimit të DST, ekspertizë e kërkuar për DST e ka kërkuar të jepet nga Agjencisë së Prokurimit Publik institucion përgjegjës.*

*Oe nuk ka ndërmend të paguaj shërbime që si ka kërkuar, kur ligji nuk ja ngarkon OE neni 86 P.PrAdministrative dhe OE gjithashtu nuk ka ndërmend të paguaj shërbime me copa letre, për shërbime të cilat nuk janë lëshuar fatura tatimore sipas ligjit, me TVSH apo pa TVSH me Nr llogarie, apo elementet e tjerë të kërkuar nga ligji..”*

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

Pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomi ankimues “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK mbi shfuqizimi e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga ana e tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Për sa i përket kundërshtimit të Vendimit nr. 189/2023, datë 09.03.2023 nga ana e operatorit ekonomik me arsyen se: *“Në formularin e ankimit, ankuesi nuk ka kërkuar ekspertizë për respektim të **Vendimi 354 datë 11.05.2016**, por të hartimit të DST, ekspertizë e kërkuar për DST e ka kërkuar të jepet nga Agjencisë së Prokurimit Publik institucion përgjegjës.”*, Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i të gjithë dokumentacionit në dosje arriti në konkluzion se i nevojitej një ekspert i fushës për një gjykim sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “STUDIO SERVICES K-SA”.

III.1.2. Sikundër cituar edhe më sipër, për shkak të specifikës së kësaj procedure prokurimi, si dhe marrë shkas nga kërkesa e ankimuesit për ekspertizë të posaçme, Komisioni i Prokurimit Publik, për gjykimin sa më të drejtë të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, vendosi të thërrasë ekspertin e fushës për përllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Eksperti u zgjidh nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar në përputhje me nenin 24 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*. Eksperti, i cili referuar dokumentacionit zotëronin kualifikimet e kërkuara për kryerjen e ekspertizës, u zgjodh Eksperti B.B.

III.1.3. Në datën 09.03.2023 në ambientet e Komisionit të Prokurimit Publik u paraqit eksperti Z. Bujar Bundo me profesion inxhinier/ekspert në përllogaritjen e kostove për shërbimet në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim, ekspert i pavarur, nga lista e ekspertëve të KPP-së. Eksperti pranon, se është i specializuar për përllogaritjen e fondit limit për përllogaritjen e vlerës minimale dhe maksimale dhe përcaktoi tarifën prej 50,000 lekë për kryerjen e ekspertizës. Gjithashtu Eksperti pranon se për kryerjen e ekspertizës i nevojiten 10 ditë kohë nga marrja e dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e përllogaritjes së fondit limit

III.1.4. Në datën 09.03.2023 me vendimin nr. 189/2023 Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të urdhërojë kryerjen e Ekspertimit të Posaçëm lidhur me përllogaritjen e vlerës minimale dhe maksimale të fondit limit për procedurën e prokurimit, nga eksperti i përzgjedhur nga lista e ekspertëve vjetorë të miratuar për procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence” me Nr. REF-27372-05-04-2022 me objekt “Hartim projekti rehabilitimi rruges “A.Goga - Spitali” me fond limit 4.166.660.0 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 2022-06-20 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durres.*
- 2. Operatori ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK të parapaguajë për llogari të z. Bujar Bundo shumën prej 50,000 lekë si tarifë e përcaktuar për kryerjen e ekspertimit dhe të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda datës 15.03.2023 ora 10:00.*

3. *Autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik ankimues "STUDIO SERVICES K - SA" SHPK të paraqesin pretendimet e tyre me shkrim mbi çështjet që duhet të trajtohen nga Eksperti brenda datës 15 .03.2023.*
4. *Në datën 15.03.2023 ora 10:00 të paraqitet pranë Komisionit të Prokurimit Publik eksperti z. Bujar Bundo për marrjen në dorëzim të dokumentacionit të nevojshëm për kryerjen e ekspertizës, si dhe përfaqësues të autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik.*
5. *Pas paraqitjes së pretendimeve me shkrim nga palët eksperti ngarkohet të kryejë aktin e ekspertimit dhe të dorëzojë materialin në formë shkresore. Akti i ekspertimit të dorëzohet jo më vonë se data 31.03.2023.*

*Ky vendim hyn në fuqi menjëherë."*

III.1.5. Në datën 15.03.2023 në ambientet e KPP, nuk u paraqit asnjë përfaqësues i autoritetit kontraktor dhe operatorit ekonomik "STUDIO SERVICES K - SA" SHPK. Gjithashtu, Komisioni vëren, se operatori ekonomik ankimues "STUDIO SERVICES K - SA" SHPK nuk ka parapaguar për llogari të z. Bujar Bundo shumën prej 50,000 lekë si tarifë e përcaktuar për kryerjen e ekspertimit dhe nuk ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, së bashku me kopje të faturës financiare të parapagimit brenda afatit të përcaktuar në vendimin e sipërcituar.

III.1.6. Në nenin 24 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, parashikohet se:

1. ***Nëse gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës Komisioni vlerëson, se për sqarimin e fakteve kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës, teknologjisë ose artit, Komisioni mund të urdhërojë marrjen e mendimit të ekspertëve ose kryerjen e ekspertizës në laboratorë të specializuar.***
2. ***Ekspertët përzgjidhen nga lista vjetore e ekspertëve të miratuar. Në rast se për shqyrtimin e çështjes kërkohet ekspertizë e posaçme dhe nuk disponohet asnjë ekspert i fushës për të cilën nevojitet ekspertizë në listën e miratuar, mund të kërkohen rast pas rasti ekspertë të pavarur nga institucione të arsimit të lartë ose struktura të tjera të posaçme.***
3. ***Komisioni njofton palët në proces për vendimin e ekspertimit, shpenzimet procedurale dhe datën e zhvillimit të seancës.***

III.1.7. Në nenin 25 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, parashikohet se:

1. ***Shpenzimet procedurale përfshijnë tarifën e ankesës dhe shpenzimet për konsultimin/ekspertizën e specialistëve/ekspertëve të pavarur.***



2. Kur Komisioni, në procesin e shqyrtimit të një ankese, urdhëron thirrjen e specialistëve ose të ekspertëve dhe kryerjen e ekspertizës, duhet të përcaktojë detyrimin e palëve për parapagimin e tyre dhe afatin.
3. Parapagimi i shpenzimeve vërtetohet duke paraqitur dokumentacionin bankar përkatës.
4. Palët në proces mbulojnë shpenzimet e ekspertizës.
5. Komisioni përcakton në vendimin që përfundon procedimin administrativ edhe detyrimin, se kujt i ngarkohen shpenzimet procedurale

III.1.8. Referuar sa më sipër, Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për kryerjen e parapagesës për llogari të ekspertit. Referuar parashtrimeve në ankesë rezulton, se vetë ankimuesi ka kërkuar për çështjen objekt-shqyrtimi, thirrjen e ekspertit të specializuar. Komisioni gjykon, se operatori ekonomik duke mos kryer parapagesën e përcaktuar nga eksperti, nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në pikën 2 të dispozitivit të vendimit nr. 189/2023 datë 09.03.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik. Sikundër pasqyruar më lart, KPP vlerësoi, se për çështjen objekt-ankimi, duhej ekspertizë e posaçme dhe për këtë arsye Komisioni mori vendimin nr.189/2023 datë 09.03.2023 për kryerjen e Ekspertimit të Posaçëm lidhur me përllogaritjen e fondit limit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Komisioni kreu të gjitha veprimet procedurale të nevojshme për shqyrtimin e ankesës, duke urdhëruar kryerjen e ekspertizës së posaçme në përputhje me nenin 24 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik, i cili parashikon se **“Nëse gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës Komisioni vlerëson, se për sqarimin e fakteve kërkohen njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës, teknologjisë ose artit, Komisioni mund të urdhërojë marrjen e mendimit të ekspertëve ose kryerjen e ekspertizës në laboratorë të specializuar”**. Kryerja e ekspertizës, kërkon gjithashtu që palët në proces të mbulojnë shpenzimet e ekspertizës, ndërsa parapagimi i shpenzimeve vërtetohet duke paraqitur dokumentacionin bankar përkatës. Në rastin konkret rezulton, se vetë pala e cila kërkoi kryerjen e ekspertizës së posaçme nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për kryerjen e parapagimit të ekspertit, i cili është i detyrueshëm për vazhdimin e mëtejshëm të procedurës së shqyrtimit administrativ. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se ankimuesi u tregua pasiv gjatë procesit të shqyrtimit administrativ duke e braktisur në një kuptim atë. KPP e gjen mosveprimin e ankimuesit për kryerjen e parapagimit të ekspertit, si tërheqje dhe braktisje të procedurës duke mos shfaqur më interes për të.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin

*e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,*

**Vendosi:**

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Shërbim konsulence*” me Nr. REF-27372-05-04-2022 me objekt “*Hartim projekti reabilitimi rruges "A.Goga - Spitali"*” me fond limit 4.166.660.0 (katër milion e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 2022-06-20 nga autoriteti kontraktor Bashkia Durres.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “STUDIO SERVICES K - SA” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**